



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.197/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gillogjani kryesuese, Kymete Kicaj dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi duke vendosur përkritazi me ankesën e Business Center PAP L.L nga Prizreni, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), me seli në Prizren, për shkak të vendosjes së billboardit në objekt privat, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** e bazuar ankesa Anr.197/2019 e datës 03.10.2019, e paraqitur nga Business Center PAP L.L nga Prizreni, subjektit politik Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja billboardit të kandidatëve për deputetë nga radhët e këtij subjekti politik, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 1,100.00 (njëmijë e njëqind) euro, të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 03.10.2019, Business Center PAP L.L, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se kandidatët për deputetë nga radhët e subjektit politik KDTP Fikrim Damka dhe Mufera Sinik kanë vendosur një billboard pa lejen e tyre në njërin anë të billboardit, i cili është në pronën private të kompanisë së tyre. Me tutje parashtruesi i ankesës shton se billboardi reklamë është në pronën private të Kompanisë së tyre, i vendosur aty 24 orë para se KDTP-ja ta mbulon atë dhe informojnë se billboardi do të rivendoset sot përsëri nga ana e tyre. Si dëshmi për pretendimet e tyre parashtruesi ka bashkangjitur ankesës disa fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.10.2019, subjekti politik KDTP, thekson se e kundërshtojmë në tërësi ankesën, sepse nuk përputhen me realitetin dhe se gabimi i bërë nuk varet nga ata, atë e ka bërë kompania të cilën e kanë kontraktuar. Po ashtu kanë shtuar se kanë kontaktuar kompaninë kontraktuese, në lidhje me këtë problem, i njëjti ka bërë kërkesë për mirëkuptim nga ana e ankuesit dhe ka shprehur gatishmëri për tërheqje të ankesës, ashtu që të gjitha problemet-gabimet janë evituar. Nuk kanë bashkangjitur provë për evitimin e shkeljes së bërë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LPZ-së, gjeti se: **Ankesa është e bazuar.**

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posteri i kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik KDTP, Fikrim Damka dhe Mufera Sinik, është i vendosur në pronë private të kompanisë Business Center PAP L.L.

Nga dëshmitë e sipërcituara paneli në mënyrë të sigurt ka vërtetuar se kandidatët për deputet nga radhët e subjektit politik KDTP, kanë bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjekte

Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se posterit është i vendosur në hapësirë private, ku paraqet veprim të sanksionuar me dispozitën e nenit 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton “ *Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe postarëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve* ”.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë të subjektit politik KDTP, se gabimi i bërë nuk varet nga ata, se atë e ka bërë kompania të cilën e kanë kontraktuar, Paneli pretendimet e tilla i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj pasi që, me këto thënie nuk justifikojnë veprimet që janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 33 pika b) i LZP-së, si dhe neni 5 paragrafi 1 pika d) të Rregullës 13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t’i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ). Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme, që do të thotë se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë, si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur në ankesë, ashtu që nëpërmes përgjigjes shihet qartë se nuk e ka pranuar shkeljen, por deklaroi se gabimi është bërë nga kompania kontraktuese për vendosjen e posterëve, dhe se të njëjtit kanë marrë masa përmirësuese, duke evituar shkeljet, ndërsa për këto veprime të njëjtit nuk kanë bashkangjitur në përgjigje asnjë provë, dhe kështu që të gjitha këto veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë, në kuptim të nenit 120 par.1 dhe nenit 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.197/2019 më datën 05.10.2019

**Kryesuese e Panelit**  
Afijete Sada Gllogjani



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.***